



**PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMIN
E MATURËS SHETËRORE PROFESIONALE 2015**

**TEORIA PROFESIONALE E INTEGRUAR:
DREJTIMI MËSIMOR “TEKSTIL-KONFEKSIONE”**

Janar, 2015

1. Udhëzime të përgjithshme

Ky program orientues ndihmon në përgatitjen e nxënësve të drejtimit “**Tekstil-konfeksione**”, me strukturë 2+1+1, për provimin me zgjedhje të detyruar “Teori profesionale e integruar” të Maturës Shtetërore Profesionale 2015. Ai synon orientimin e përgatitjes së nxënësve nëpërmjet përqendrimit në njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të lëndëve teorike profesionale. Njëherazi, ndihmon edhe në verifikimin paraprak të përgatitjes përfundimtare të nxënësve sepse mundëson zhvillimin e testeve përmblendhëse. Programi orientues për provimin e “Teorisë profesionale të integruar” bazohet në:

- programet orientuese për Provimet Përfundimtare në: drejtimin “Tekstil-konfeksione”, Niveli I dhe “Konfeksione (pilot-PEM)”, Niveli I; në profilin “Rrobaqepësi”, Niveli II dhe profilin “Tekstil”, Niveli II;
- programet e lëndëve teorike profesionale të drejtimit “Tekstil- konfeksione”, Niveli III (klasa e 13-të);
- Udhëzimin e përbashkët të MAS dhe MMSR nr. 2, datë 06.02.2015 “Për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale 2015 në Republikën e Shqipërisë”.
- Rregulloren e Maturës Shtetërore 2015 në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Urdhërin e Ministrit nr.61, datë 10.02.2015.”.

Në të përfshihen njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të këtyre programeve. Për Bazat e sipërmarrjes, janë marë parasysh vetëm njohuritë e reja dhe jo veprimtaritë praktike.

2. Udhëzime për zbatimin e programit

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes sepse evidenton dhe përforcon njohuritë teorike, por dhe aftësitë e nxënësve për aplikimin e njohurive në situata të njohura e të reja, analizën dhe vlerësimin e këtyre situatave. Specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të kësaj lënde, nuk duhet të përfshijnë për vlerësim tema mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program. Përgatitja e nxënësve për provim të bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe duke përdorur një larmi metodash dhe mjetesh.

Gjatë punës për përgatitjen e nxënësve për provimin me zgjedhje të detyruar “Teori profesionale të integruar” të Maturës Shtetërore Profesionale, është e rëndësishme që herë pas here mësuesi të zhvillojë teste të nxënësve të tij, me teste që mund t’i hartojë vetë duke u bazuar në modelet e mëparshme të testeve të Maturës Shtetërore për teorinë profesionale.

Testi për drejtimin mësimor “**Tekstil- konfeksione**” do të ndërtohet në mënyrë të tillë ku të jenë të përfshira të tri nivelet e vështirësisë: niveli bazë, niveli mesatar dhe niveli i

lartë. Njëkohësisht, edhe shpërndarja e pikëve në test do të jetë në varësi të përqindjeve që zë çdo nivel. Gjatë hartimit të njësive të testit duhet të mbahen parasysh synimet e përgjithshme, në skeletkurrikulat përkatëse, të temave të përzgjedhura në këtë program.

Nxënësit duhet të kenë parasysh se lënda, e cila ka peshën më të madhe në këtë program orientues të Maturës Shtetërore Profesionale, në test do të përfaqësohet nga një numër më i madh pyetjesh.

3. Lëndët dhe temat përkatëse

Në programin orientues të provimit të “Teorisë profesionale të integruar” në kuadrin e provimit me zgjedhje të detyruar “Teori profesionale e integruar”, të Maturës Shtetërore Profesionale, për drejtimin mësimor “Tekstil- konfeksione”, do të përfshihen programet e lëndëve profesionale të mëposhtëme:

1. Baza të prerjes dhe qepjes, kl. 10. kl. 11.
2. Njohuri tekstili dhe trikotazhi (Materialet e konfeksioneve), kl. 11.
3. Njohuri për makinat e tekstil konfeksionit, kl. 10. kl. 11.
4. Estetika e veshjes, kl. 11.
5. Bazat e sipërmarrjes, kl. 12. kl. 13.
6. Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm, kl. 13.
7. Organizimi dhe legjislacioni në industrinë e tekstil-konfeksioneve kl. 13.
8. Histori e kostumeve dhe e modes kl. 13.
9. Koleksioni dhe marketingu i modes kl. 13.

Tabela 1: Lëndët dhe peshat përkatëse në programin orientues

Nr	Lënda	Vëllimi i orëve për çdo lëndë	Peshat në %
1	Baza të prerjes dhe qepjes	58	24
2	Njohuri tekstili dhe trikotazhi (materialet e konfeksioneve)	22	9
3	Njohuri për makinat e tekstil konfeksionit	40	16
4	Estetika e veshjes	19	8
5	Bazat e sipërmarrjes	19	8
6	Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm	14	5
7	Organizimi dhe legjislacioni në industrinë e tekstil-konfeksioneve	23	10

8	Histori e kostumeve dhe e modës	20	8
9	Koleksioni dhe marketingu i modës	31	12
	TOTALI	246	100%

Temat sipas lëndëve janë:

- a) **“Baza të prerjes dhe qepjes”, kl. 10 dhe 11: (58 orë)**
- Masat e trupit të njeriut dhe tabelat e përmasave 4 orë
 - Njohuri mbi bazat e prerjes 2 orë
 - Fundi i thjeshtë 4 orë
 - Pantallonat e thjeshta për femra 5 orë
 - Bluza për femra 4 orë
 - Llojet e jakave për fustane dhe bluza 6 orë
 - Këmisha për meshkuj 6 orë
 - Pantallona për meshkuj 6 orë
 - Rrudhat dhe palat 2 orë
 - Filetot 2 orë
 - Xhepat 3 orë
 - Jakat 4 orë
 - Qepja e fundit për femra 4 orë
 - Qepja e bluzës për femra 6 orë
- b) **“Njohuri tekstili dhe trikotazhi (materialet e konfeksioneve)”, kl.10 dhe 11: (22 orë)**
- Njohuri të përgjithshme për fibrat teksile 4 orë
 - Filli 6 orë
 - Pëlhura 8 orë
 - Vetitë e tekstileve 4 orë
- c) **“Njohuri për makinat e tekstil konfeksionit”, kl.10 dhe 11: (40 orë)**
- Njohuri për makinat e qepjes së drejtë 10 orë
 - Përdorimi i makinave të qepjes së drejtë 6 orë
 - Defektet në makinat qepëse dhe rregullimi i tyre 8 orë
 - Njohuri për makinat hekurosëse 4 orë
 - Njohuri për makinat e proceseve ndihmëse 6 orë
 - Njohuri për makinat e qepjes së trikotazheve 6 orë
- d) **“Estetika e veshjes”, kl. 11: (19 orë)**
- Njohuri mbi estetikën 3 orë

• Historiku i veshjeve	3 orë
• Origjina e veshjeve popullore	4 orë
• Karakteristikat e veshjeve popullore	4 orë
• Prerjet dhe zbukurimet në veshjet popullore	5 orë
d) “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12 dhe 13:	(19 orë)
• Tregu dhe sjellja konsumatore	5 orë
• Legjislacioni i punës	5 orë
• Menaxhimi i informacionit	4 orë
• Menaxhimi i marketingut	5 orë
i) Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm, kl. 13:	(14 orë)
• Burimet kryesore të mjedisit dhe degradimi mjedisor	3 orë
• Ndikimi i veprimtarisë së njeriut në mjedis	3 orë
• Zhvillimet demografike dhe mjedisi	4 orë
• Shoqëria e konsumit dhe mbetjet	4 orë
e) “Organizimi dhe legjislacioni ne industrine e tekstil-konfeksioneve”, kl.13:	(23 orë)
• Organizimi i punës	2 orë
• Cikli i prodhimit	4 orë
• Sistemi i organizimit të prodhimit	3 orë
• Plani operacional dhe i shpërndarjes	4 orë
• Nisja e një biznesi të ri	2 orë
• Format ligjore të pronësisë dhe çështjet e taksimit	4 orë
• Bazat e eksportit	4 orë
f) “Histori e kostumeve dhe e modës”, kl.13:	(20 orë)
• Historia e veshjeve gjatë epokës së Antikitetit	2 orë
• Historia e kostumeve dhe e modës në Mesjetë	2 orë
• Moda gjatë fillim shekullit të XX deri më vitet '30	4 orë
• Moda gjatë viteve '60	2 orë
• Moda gjatë viteve '70	3 orë
• Moda gjatë fillim shekullit të XXI	4 orë
• Historia e kostumeve dhe e modës në Shqipëri	3 orë
g) “Koleksioni dhe marketingu i modës”, kl.13:	(31 orë)
• Prezantimi i koleksionit	6 orë
• Strategjia e marketingut	5 orë
• Marketingu mix	14 orë
• Plani i marketingut	6 orë

